



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 635 prot.

Tiranë, më 24. 04. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 114, datë 24. 04. 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 212 Regj., datë 13.10.2023<sup>3</sup>, depozituar nga subjekti ankues A. A., kundër Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tropojë (ZVAP Tropojë), me pretendimin e diskriminimit për shkak të *gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore dhe çdo shkak tjetër*<sup>4</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, A. A., thekson se që prej muajit korrik 2022 është pezulluar nga puna si ish Përgjegjëse e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë dhe është nën hetim dhe me masë detyrim paraqitje deri në përfundim të hetimeve nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Më tej ajo shpjegon se është nënë e 7 fëmijëve dhe me një status të tillë ajo ka nevojë për punë. Sakaq, gjatë vitit 2022 ka aplikuar për praktikë profesionale pranë ZVAP Tropojë, por i është refuzuar praktika me argumentin që është nën hetim. Gjithashtu, referuar faktit që ka përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në programin “Edukim Fizik dhe Sporte”, ka kërkuar pranë ZVAP Tropojë të ushtrojë profesionin e Mësuesisë në lëndën e Edukimit Fizik, në një nga shkollat që mbulon kjo zyrë arsimore, por ka marrë sërish përgjigje negative. Sipas saj, drejtuesja e ZVAP Tropojë, pavarësisht faktit që ka orë të lira në lëndën e Edukimit Fizik, ato i shpërndahen mësuesve jashtë profili.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>3</sup> Plotësuar nga ankuesja përmes e-mail-it datë 24.10.2023.

<sup>4</sup> Subjekti ankues nuk ka përcaktuar asnjë informacion lidhur me këtë shkak.

Sa më sipër, A. A. shpjegon se mbështetur në legjislacionin shqiptar, deri në përfundim të hetimeve nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë ajo prezumohet e pafajshme dhe si e tillë duhet të ketë të drejtën të punësohet, për të mbajtur familjen e saj.

Ankuesja thekson se është vënë në pozita diskriminuese nga ana e ZVAP Tropojë duke iu mohuar e drejta e ushtrimit të praktikës profesionale dhe e punësimit të saj për shkak të faktit që ajo është në proces hetimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Sakaq, A. A. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim nga ana e ZVAP Tropojë dhe të ndërmarrë masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimeve diskriminuese kundrejt saj.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 1105/1 prot., datë 26.10.2023, i është drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tropojë, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, ZVAP Tropojë përmes shkresës<sup>5</sup> nr. 410/1 prot., datë 06.11.2023, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër të tjera se: “...A. A. për rastin e aplikimit të Portalit E-Albania për zhvillimin e Praktikës Profesionale i është kthyer kjo përgjigje nga ana e ZVAP Tropojë:

Në urdhrin Nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale, për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, në Nenin 14, Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale, pika 3, përcakton se kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

dh) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore,

e) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim penal.

Kriteri i pikës “e”, kërkohet për të mos lejuar zhvillimin e praktikës profesionale nga kandidatë që janë në procedim penal, në vijim, nga organi i Prokurorisë.

Për rastin e ankesës së saj në Platformën e Bashkëqeverisjes ZVAP Tropojë i ka kthyer këtë përgjigje A. A.: “Në përgjigje të kërkesës tuaj, të datës 29.09.2023, ju sqarojmë sa më poshtë vijon: Bazuar në Udhëzimin Nr. 17, datë 26.7.2023, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2012 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, 19. Pika 1 e kreut 10 ndryshon si më poshtë:

b. mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/I të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.

Si dhe në paragrafin 6, Pika 4/1 e Kreut 2, ndryshohet si më poshtë: “4/1 Mësuesi nuk mundet të punësohet dhe, kur është i punësuar përfundon marrëdhënien e punës në rast se:

a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarave për Krime Seksuale ose,

b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.”

Gjatë periudhës së dytë, kur keni aplikuar për Praktikën tuaj profesionale, 12.12.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me Nr. 285 prot., datë 07.11.2022, figuron se ju keni qenë në hetim për disa çështje gjyqësore në ngarkimin tuaj. Përsa më sipër kërkesa juaj për punësim në IAP të ZVAP Tropojë duhet të përditësohet me dy dokumente shtesë:

1. Vërtetim nga prokuroria që nuk keni në ngarkim asnjë proces penal;

2. Vërtetim nga gjykata se nuk jeni në një proces gjyqësor në vazhdim.

<sup>5</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1105/2 prot., datë 09.11.2023.

*Me plotësimin e këtyre dy dokumenteve ZVAP Tropojë do të vijojë me njoftimin si kandidat për listat e punësimit jashtë portalit”.*

*Këto dokumente nuk janë paraqitur nga ana e saj në ZVAP Tropojë.*

*Bazuar në Ligjin Nr. 69/2012 “Për Arsimin Parauniversitar”, mësuesi duhet të ketë këto kritere të detyrueshme për punësimin e tij:*

*Neni 57, Profesioni i mësuesit I. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të:*

*a) Mësuesi i arsimit parashkollor: diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”;*

*b) Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare.*

*2. Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara, duhet të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit.*

*3. Diplomat e njëvlershme me diplomat e sipërpërmendura përcaktohen me udhëzim të ministrit.*

*4. Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar në provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.*

*5. Institucionet arsimore, që shërbejnë për kryerjen e praktikave mësimore të studenteve të mësuesisë dhe të praktikave profesionale të atyre që janë të diplomuar për mësues, përzgjidhen në bazë të kritereve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.*

*Aktualisht në ZVAP ka një vend të lirë për mësues të edukimit fizik.*

*Institucioni i arsimit parauniversitar ku aktualisht ndodhet ky vend i lirë pune është Shkolla e Mesme e Bashkuar “Hoxhë Zogu” Zogaj/Tropojë.*

*Në vitin 2022-2023, A. A. nuk ka dorëzuar kërkesë për punësim, sepse menaxhimi i kërkesave për punë jashtë Portalit “Mësues për Shqipërinë”, mbështetet në udhëzimin nr. 12, datë 10.06.2021, i ndryshuar, kreu 9, pika 6.*

*Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në dispozitat 3,4,5 të këtij kreu lidhet me afat të caktuar deri në momentet e paraqitjes së një kandidati nga Portali “Mësues për Shqipërinë”, por në asnjë rast jo më shumë se 10 ditë pune pas përfundimit të vitit mësimor, sipas përcaktimeve të ministrit.*

*Duke qenë se zonja A. A. nuk ka sjellë dosje për vitin shkollor 2022-2023, ZVA Tropojë nuk ka bërë rankimin e dosjes së ankueses për shkak të mungesës së saj.*

*ZVA Tropojë për profilin Edukim Fizik ka pasur 5 (pesë) kërkesa për punë, të gjitha të depozituara në protokoll.*

*ZVAP Tropojë ka vlerësuar vetëm dosjet e punëkërkesve të Shtatorit 2023.*

*Kërkojmë nga ana e Drejtorisë së Hetimit Administrativ të verifikojë te subjekti ankues nëse disponon një fletë poste që ka dorëzuar dosjen personale në Shtator 2023 pranë ZVA dhe institucioni jonë nuk e ka marrë parasysh.*

*Mësues të Edukimit Fizik për vitin 2022-2023 është L. Sh. i punësuar nga Portali “Mësues për Shqipërinë”. Mësues të Edukimit Fizik për vitin 2023-2024 është D. Sh. e punësuar nga Portali “Mësues për Shqipërinë”.*

*Në shkollën 9 vjeçare “Mushak Kadria” Margegaj për arsye të dhënies së dorëheqjes së drejtorit të shkollës, i cili kaloi si mësues i edukimit fizik, tani nuk ka vend të lirë.*

*Për vendin e pretenduar nga zonja theksojmë se pozicioni i punës ka kaluar sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 12, datë 10.06.2021.*

*Punësimet e mësuesve të edukimit fizik janë kryer bazuar në renditjen e mësuesve pas rezultateve të tyre në Portalin “Mësues për Shqipërinë”, të Udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.*

*Si konkluzion ZVAP Tropojë në këtë rast ka zbatuar me përpikëri legjislacionin lidhur me punësimin e kandidateve në fushën e arsimit parauniversitar për kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe të atyre që kanë pasur kërkesa për punë.”.*

2. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 10.11.2023, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e ZVAP Tropojë. Në përgjigje të këtij e-maili, në të njëjtën datë ankuesja vuri në dispozicion të Komisionerit parashtrimet e saj.

*Mbështetur në e-mail-in e sipërcituar, A. A. parashtrroi ndër të tjera se: “Nuk qëndron asnjë pretendim i tyre sepse unë kam bërë kërkesë me shkrim drejtuar ZVA Tropojë për pozicionet e lira në mësuesi në Edukim Fizik për pozicionin mësues jashtë portalit sipas njoftimit në faqen zyrtare të ZVA Tropojë në Facebook.*

*Unë me datën 01.09.2023 jam paraqitur fizikisht në ZVA Tropojë për të dorëzuar dosjen për punë pranë burimeve njerëzore dhe shefi i kuadrit, të paktën i prezantuar si i tillë, D. I. nuk ma ka pranuar dosjen fizikisht dhe më ka kërkuar që t’ia u drejtoj në rrugë postare.*

*Unë po atë ditë dosjen me kërkesën për punë e kam dërguar me postë, bashkëngjitur këtij e-maili po ju dërgoj edhe mandatin e postës ku mandati i datës 01.09.2023 është me kërkesën për punë bashkë me fletën e marrjes nga ZVA Tropojë, L. L. Për këtë kërkesë nuk kam marrë asnjë herë përgjigje me shkrim dhe kam komunikuar edhe në telefon me D. I. të cilin e kam pyetur në lidhje me faktin se përse nuk më keni kthyer një përgjigje pasi ju po i shpërndani orët tek mësues jashtë profili dhe pa arsim që më konkurron mua dhe unë menjëherë pas kësaj bisede me telefon, më datë 28.01.2023 kam bërë një ankesë me shkrim në lidhje se përse nuk po marrë një përgjigje në lidhje me kërkesën time për punë, pasi drejtoresha e arsimit Sh. B. i plotësoi kontratat e punës sipas dëshirës dhe jo sipas kriterëve dhe kualifikimeve, bashkëngjitur po ju dërgoj edhe mandatin e postës.”.*

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 84 prot., datë 15.01.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në

seancë dëgjimore, duke iu bërë të ditur se, secila prej tyre mund të depozitohet gjatë seancës, shpjegime si dhe dokumentacion provues në favor të argumenteve të veta.

Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 22.01.2024, me praninë e subjektit ankues personalisht, ndërsa nga ana e ZVAP Tropojë nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Pala ankuese u qëndroi të njëjtave pretendime si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimit e depozituara prej saj para KMD-së, duke shtuar ndër të tjera se nga ana e ZVAP Tropojë nuk është pranuar kërkesa për kryerjen e praktikës profesionale dhe për punësim, për shkak të gjendjes shoqërore të saj, si person i cili është në proces hetimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Sipas ankuses, referuar korrespondencës së mbajtur me KMD-në, Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe Platformën e Bashkëqeverisjes, ZVAP Tropojë nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Gjithashtu ankuesja theksoi se, referuar shkresës kthim përgjigje drejtuar Komisionerit, ZVAP Tropojë ka parashtruar se ajo nuk ka paraqitur kërkesë për punësim, ndërsa në përgjigjet drejtuar DRAP Lezhë dhe Platformës së Bashkëqeverisjes, ZVAP citon se jo nuk ka plotësuar dokumentacionin sa i përket vërtetimeve që nuk është në hetim nga prokuroria apo gjykata.

Në përfundim, ankuesja shtoi se në shkollën Margegaj, është emëruar një mësues i Edukimit Fizik i cili nuk i plotëson kriteret e arsimit duke ju mohuar asaj emërimi në këtë pozicion pune.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, përmes e-mail-it datë 24.01.2024, Komisioneri iu drejtua sërish ZVAP Tropojë, duke i përcjellë parashtrimet e subjektit ankues të cituara gjatë seancës dëgjimore dhe duke kërkuar, si më poshtë citohet:

Referuar pretendimeve të paraqitura në seancën dëgjimore, A. A. pretendoi se për pozicionet e lira për mësues të edukimit fizik jashtë portalit, ZVAP Tropojë, nuk kërkon dokumentacion apo vërtetime nga gjykata apo prokuroria. Sipas A. A., vetëm për të, ZVAP Tropojë ka kërkuar vërtetim nga gjykata dhe prokuroria. Gjithashtu, A. A., theksoi faktin se pozicionet e lira për mësues nga jashtë portalit të Edukimit Fizik, ZVAP Tropojë i ka plotësuar me mësues jashtë profilit dhe mësues që nuk e disponojnë arsimin përkatës për këtë pozicion pune.

Sa më sipër, u kërkua të vihet në dispozicion të shqyrtimit të çështjes, kopje e dosjeve të mësuesve të emëruar jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë" të edukimit fizik, për vitin shkollor 2022-2023 dhe 2023-2024 (Arsimi përkatës). Cili është dokumentacioni i kërkuar nga ana e ZVAP Tropojë, lidhur me punësimin e mësuesve të edukimit fizik nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë"? Lidhur me këtë, u kërkua të vihen në dispozicion kopje të publikimeve të bëra për plotësimin e vendeve vakante të sipërcituara për vitin shkollor 2022-2023 dhe 2023-2024.

5. Në vijim të kërkesës së mësipërme të KMD-së, nëpërmjet e-mail-it datë 02.02.2024, ZVAP Tropojë, informoi Komisionerin ndër të tjera se:

*"... A. A. asnjëherë nuk ka qenë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar. Gjatë vitit shkollor 2022-2023 nuk kemi pasur kërkesa për tu punësuar nga A. A.*

Gjatë vitit shkollor 2023-2024, deri tani kemi pasur këto kërkesa për mësues të profilit Edukim Fizik:

- Përmes Portalit "Mësues për Shqipërinë" është punësuar mësuesja: D. Sh., në SHMB "Ali Iber Neza" Tropojë.
- Jashtë portalit është punësuar në SHMB "Murat Paci" Pac, znj. E. P., me arsim të lartë, master në Edukim Fizik".

Bashkëngjitur ZVAP Tropojë vuri në dispozicion të Komisionerit kopje te dosjeve të mësuesve të emëruar jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë" të edukimit fizik, për vitin shkollor 2023-2024 (Arsimi përkatës) dhe dokumentacionin, lidhur me punësimin e mësuesve të edukimit fizik nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë".

6. Në vijim, përmes e-mail-it datë 14.02.2024, Komisioneri i përcolli ankueses parashtrimet e ZVAP Tropojë.

Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar A. A. me e-mail-in e të të njëjtës datë, kundërshtoi pretendimet e ZVAP Tropojë dhe mbajti të njëjtin qëndrim që ka pretenduar edhe gjatë seancës dëgjimore.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: " "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre".

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

#### **A. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e ZVAP Tropojë.**

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me kandidat të tjerë për praktikën profesionale apo mësues të edukimit fizik jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit.

#### **A. 1. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë e të pafavorshëm, sa i përket refuzimit për zhvillimin e praktikës profesionale pranë ZVAP Tropojë.**

*Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:*

Mbështetur në informacionin e administruar, A. A., ka përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në programin “Edukim Fizik dhe Sporte”. Më datë 12.12.2022, ajo ka aplikuar përmes portalit e-Albania, për zhvillimin e Praktikës Profesionale pranë institucioneve arsimore të ZVAP Tropojë, por është refuzuar nga kjo e fundit me arsyetimin se ankuesja ka qenë në proces hetimi nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Për këtë, ankuesja është vënë në dijeni përmes portalit e-Albania me e-mail datë 20.12.2022, në të cilin citohej se:

*“Në urdhrin Nr. 100, datë 25.2.2022, “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale”, për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, në Nenin 14, Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale, pika 3, përcakton se kandidati i*



interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online edhe dokumentacionin e mëposhtëm: dh) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore, e) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim penal. Kriteri i pikës “e”, kërkohet për të mos lejuar zhvillimin e praktikës profesionale nga kandidatë që janë në procedim penal, në vijim, nga organi i Prokurorisë”.

Urdhri Nr. 100, datë 25.02.2022, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e Rregulloreve për organizimin dhe zhvillimin e Praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, në nenin 4, parashikon se: “1. Ka të drejtë për të zhvilluar praktikën profesionale kandidati që përmbush kriteret si vijon:

- a. ka fituar diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë ose diplomë të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- b. ka fituar diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë ose diplomë të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nuk ka ushtruar profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të kohës.
- c. Profili ku kandidati do të regjistrohet për të zhvilluar praktikën profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, duhet të lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati...”.

Ndërsa neni 14, i Urdhrit të sipërcituar parashikon ndër të tjera se: “1. Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë bëhet nëpërmjet platformës së aplikimit online.

2. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale përzgjedh IAPP-në nga lista e publikuar në faqen e DPAP-së.
3. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet si më poshtë:
  - a. shtojca nr. 5, “Formulari i aplikimit”, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje dhe pjesë përbërëse e saj;
  - b. jetëshkrimi i praktikantit;
  - c. dokumenti identitetit (ID);
  - ç. diplomat në fushën e mësuesisë ose diploma të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe lisën e notave për secilën diplomë;
  - d. raportin mjeko-ligjor;

*dh. vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;*

*e. vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim penal.*

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni janë të detyrueshme dhe duhet jenë të skanuara nga origjinali.
5. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar në platformën online, sipas shtojcës nr. 5, përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale...”.

Neni 15, Pranimi i praktikantëve, përcakton se:

1. ZVAP-të pranojnë aplikime për kryerjen e praktikës profesionale dhe realizojnë procedurat për shpërndarjen e tyre në institucionet arsimore.
2. Aplikuesit përzgjidhen sipas këtyre përparësive:
  - a. Aplikuesi, për të cilin në vitin paraardhës shkollor nuk ka qenë i disponueshëm ndonjë institucion arsimor parauniversitar publik ose privat.
  - b. Aplikuesi që banon në qytetin/fshatin ku gjendet IAPP-ja, për të cilin ka aplikuar.
3. ZVAP njofton aplikuesit që do të zhvillojnë praktikën profesionale për IAPP-në përkatëse.
4. Nëse në ZVAP, për të cilën është aplikuar, nuk disponohet ndonjë IAPP në sistemin arsimor publik ose privat për zhvillimin e praktikës profesionale, DRAP-ja i ofron aplikuesit për praktikant IAPP në ZVAP të tjera, në juridiksion të saj”.

Në analizë e konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstatoi se, ankuesja ka fituar diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë në programin “Edukim Fizik dhe Sporte”, sipas përcaktimeve në nenin 4 të Urdhrit të sipërcituar. Në këto kushte dhe referuar parashkrimeve të paraqitura, ankuesja më datë 12.12.2022, ka ngarkuar në platformën online e-albania, të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas parashkrimeve të nenit 14 të Urdhrit të sipërcituar.

Në përgjigje të aplikimit, nga sistemi online, e-albania, ankuesja është vënë dijeni se nuk i është pranuar aplikimi i saj si rezultat i faktit që vërtetimi i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me nr. 285 prot., datë 07.11.2022, citon se ajo është në hetim për disa çështje gjyqësore në ngarkim të saj.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme, nga ana e ZVAP Tropojë, sa i përket mospranimit të aplikimit të saj për zhvillimin e praktikës profesionale, pasi, referuar akteve nënligjore të sipërcituara, ZVAP Tropojë ka vepruar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e ZVAP Tropojë, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja, sa i përket mospranimit të aplikimit të saj për zhvillimin e praktikës profesionale.

**A. 2. Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim në mënyrë të padrejtë e të pafavorshëm nga ZVAP Tropojë, sa i përket refuzimit për punësim si mësuese e edukimit fizik jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”.**

Mbështetur në provat e administruara, në datat 23.08.2023 dhe 01.09.2023, në faqen e Facebook, ZVAP Tropojë ka publikuar<sup>6</sup> *“Njoftim mbi vendet e lira të punës pas procedurave të Lëvizjes Paralele për vitin shkollor 2023-2024 në IAP të ZVAP Tropojë”*. Referuar publikimit të bërë në datën 01.09.2023, ankuesja ka konstatuar se në ZVAP Tropojë janë 4 (katër) vende të lira për mësues të edukimit fizik.

Në këto kushte, mbështetur në provat e administruara, ankuesja më datë 01.09.2023 dhe 28.09.2023, përmes Postës Shqiptare, ka dërguar pranë ZVAP Tropojë, dokumentacionin dhe aplikimin e saj për punësimin në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga ana e ZVAP Tropojë me shkresën nr. 410/1 prot., datë 06.11.2023, theksohet fakti se ankuesja nuk ka depozituar dokumentacionin dhe aplikimin e saj për punësimin në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik. Sakaq, për këtë arsye nuk është vlerësuar nga ZVAP Tropojë dosja e ankueses për vitet shkollore 2022-2023 dhe 2023-2024.

Ndërsa, referuar përgjigjeve drejtuar ankueses përmes e-mail-it datë 02.10.2023, nga ana e Zyrës së Bashkëqeverisjes dhe ZVAP-së Tropojë, rezulton se kërkesa e saj për punësim nuk i është pranuar për shkak të mungesës së: Vërtetimit nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe Vërtetimit nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim. Në vijim, ankueses i është sqaruar se: *“Me plotësimin e këtyre dy dokumenteve ZVAP Tropojë do të vijojë me njoftimin si kandidat për listat e punësimit jashtë portalit”*.

Gjithashtu, mbështetur në informacionin e përcjellë pranë KMD-së, ZVAP Tropojë nuk ka pranuar në asnjë moment që A. A. ka aplikuar për punësim në një prej vendeve vakante të publikuara për mësues të edukimit fizik. ZVAP Tropojë nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion sa i përket dokumentacionit që kërkohej nga kandidatët për punësim në një prej vendeve vakante të publikuara nga jashtë portalit *“Mësues për Shqipërinë”*. Megjithatë, përmes shkresës nr. 410/1 prot., datë 06.11.2023, drejtuar Komisionerit, ka theksuar ndër të tjera faktin se, referuar parashikimeve të Udhëzimit Nr. 17, datë 26.7.2023, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2012 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të ndryshuar, mësuesi nuk mundet të punësohet dhe, kur është i punësuar përfundon marrëdhënien e punës në rast se: është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarave për Krime Seksuale ose, është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer. ZVAP Tropojë ka cituar edhe faktin që mësuesi edhe nëse është i punësuar pezullohet ose largohet nga puna kur është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar.*

<sup>6</sup>[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=pfbid0kC5tO6jzrS4y8o3VnLWeSSC8WxvbnWqovjCMzhRyKsJEA4MjuRcbKVGeFZZUovMl&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0kC5tO6jzrS4y8o3VnLWeSSC8WxvbnWqovjCMzhRyKsJEA4MjuRcbKVGeFZZUovMl&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg)  
[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=pfbid02b88Qn4gLETyGzDGEwUqD6XHNNbHkijNJx2Lkw1egTraK7wvdm13rDiqkXhjbYldGl&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02b88Qn4gLETyGzDGEwUqD6XHNNbHkijNJx2Lkw1egTraK7wvdm13rDiqkXhjbYldGl&id=100064187433283&mibextid=WiMSqg)

Sipas informacionit të përcjellë nga ana e ZVAP Tropojë, në pozicionet e lira të publikuara për mësues të edukimit fizik, janë punësuar:

- nga portali “Mësues për Shqipërinë”, D. Sh., në shkollën e mesme të bashkuar “Ali Iber Neza”, Tropojë, me diplomë universitare të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”;
- nga jashtë portalit “Mësues për Shqipërinë”, E. P., në shkollën e mesme të bashkuar “Murat Paci”, Pac, me diplomë universitare të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”;
- në shkollën 9-vjeçare “Mushak Kadria”, Margegaj, për arsye të dhënies së dorëheqjes nga pozicioni i drejtorit të shkollës, mësuesi është punësuar në lëndën e edukimit fizik. Lidhur me këtë nuk është përcjellë asnjë dokument nga ana e ZVAP Tropojë;
- ndërsa në shkollën e mesme të bashkuar “Hoxhë Zogu”, Zogaj, Tropojë, vendi është i lirë.

Sa më sipër, Komisioneri, mori në analizë legjislacionin sa i përket pranimit dhe emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 57, ka parashikuar kriteret e detyrueshme për punësimin e mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar, duke përcaktuar se: “

1. Mësuesi në institucionin arsimor duhet të ketë fituar diplomën e mëposhtme në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të:
  - a) Mësuesi i arsimit parashkollor: diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”;
  - b) Mësuesi i arsimit fillor, mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe mësuesi i gjimnazit: diplomë e ciklit të dytë të studimeve universitare.
2. Mësuesi i shkollave të arsimit profesional, që jep lëndë profesionale, ai i arsimit të orientuar dhe mësuesi, që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara, duhet të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit.
3. Diplomat e njëvlershme me diplomat e sipërpërmendura përcaktohen me udhëzim të ministrit.
4. Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar në provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
5. Institucionet arsimore, që shërbejnë për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të mësuesisë dhe të praktikave profesionale të atyre që janë të diplomuar për mësues, përzgjidhen në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit.
6. Për nevoja të procesit mësimor, institucioni vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar emëron mësues në dispozicion, që plotësojnë kriteret e këtij neni”.

Pika 2/1, e nenit 60, të ligjit të sipërcituar parashikon se: “Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, në rastet kur:

- a) gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal;
- b) mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale, sipas nenit 60/1, të këtij ligji.”.

Neni 60/1, “Ndalimi për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar”, i ligjit nr. 69/2012, sipërcituar, parashikon se: “Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës, në rast se:

- a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale; ose
- b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht, nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.”.

Udhëzimi Nr. 17, datë 26.7.2023, i Ministrit për Arsimin dhe Sportin, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2012 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, në pikën 4/1 të Kreut 2, “Konkurrimi”, parashikon se: “4/1. Mësuesi nuk mund të punësohet dhe, kur është i punësuar, përfundon marrëdhënien e punës në rast se:

- a) është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale; ose ,
- b) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e punonjësit arsimor ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin arsimor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal”.

Në Kreun 9, të Udhëzimit parashikohet ndër të tjera se:

1. Kur në një ZVAP nuk ka kandidatë të renditur në portal, sipas profilit që përkon me vendin e lirë të punës, njoftohen dhe emërohen kandidatët e renditur në portal në një profil të përafërt me profilin e kërkuar, duke respektuar procedurat e këtij Udhëzimi.
2. Profili i përafërt përcaktohet sipas udhëzimit të ministrit të MASR-së Nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
3. Në mungesë të kandidatëve të portalit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP-ja vepron si më poshtë:
  - a) Nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin fillor, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsim fillor” sipas renditjes.
  - b) Nëse nga IAP-të do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, ZVAP-ja do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve duke i renditur të gjithë kandidatët e të gjitha profileve dhe do të punësojë kandidatët që kanë renditjen më të mirë.

4. *Për institucionet arsimore parauniversitare të arsimit të mesëm të lartë të orientuar, profilet e artit pamor dhe muzikës, në lëndët e specialiteteve punësohen specialistë që janë renditur në portal sipas titullit të diplomës. Kjo kategori mund të punësohet edhe në arsimin e mesëm të ulët për lëndët e artit pamor dhe muzikës sipas renditjes së përgjithshme.*
5. *Deri në plotësimin e vendit të lirë të punës nga lista e portalit të ZVAP-së, ose nga kandidatët e portalit nga të gjitha ZVAP-të në varësi të DPAP, bëhet punësimi me afat të caktuar me kandidatë të tjerë të profilit të përafërt në ZVAP dhe në mungesë të tyre me kandidatë të këtij profili ose profili të përafërt, të cilët kanë paraqitur kërkesë në ZVAP, duke bërë renditjen e tyre. Lista e kandidatëve të kësaj kategorie bëhet publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së, dërgohen në DRAP, 5 ditë pas fillimit të vitit shkollor dhe brenda 5 ditëve të para të çdo muaji, nëse gjatë vitit shkollor ka punësime të tilla.*
6. *Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij kreu lidhet me afat të caktuar, deri në momentin e paraqitjes së një kandidati nga portali “Mësues për Shqipërinë”, por në asnjë rast jo më shumë se 10 ditë-pune pas përfundimit të vitit mësimor, sipas udhëzimit të ministrit.*

Pika 1 e Kreut 10, të Udhëzimit të sipërcituar, “Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit”, parashikon se: “1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, në rastet si më poshtë:

- a) gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal;
- b) *mësuesi është në proces hetimi për kryerjen e një vepre penale sipas nenit 60/1 të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar*”.

Gjithashtu, Shtojca 1 e Udhëzimit të sipërcituar, përcakton listën e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e aplikimit për mësues të sistemit arsimor parauniversitar, ku sipas saj kandidati duhet të dorëzojë:

1. *Jetëshkrimin;*
2. *Kërkesë me shkrim për konkurrim sipas modelit të shtojcës 4 të këtij udhëzimi;*
3. *Kopje të kartës së identitetit;*
4. *Raport mjeko-ligjor;*
5. *Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 të këtij udhëzimi;*
6. *Vërtetim i qendrës së banimit;*
7. *Kopje të librezës së punës;*
8. *Kopje të diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.*
9. *Kopje të licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;*
10. *Kopje e dëshmive të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues Mjeshër”.*
11. *Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR.*

12. *Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja;*

13. *Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve që paraqitura sipas shtojcës 6 të këtij udhëzimi.*

Në analizë të parashikimeve ligjore të sipërcituara dhe provave të administruara nga palët në proces, Komisioneri konstatoi se:

- Referuar dëftesës postare të depozituar nga ana e ankueses, rezulton që ajo ka aplikuar për punësimin në një prej vendeve të lira të publikuara për mësues të edukimit fizik, në institucionet arsimore të ZVAP Tropojë edhe pse nga ana e kësaj të fundit mohohet një fakt i tillë.
- Pavarësisht faktit që nga ana e Komisionerit u kërkua që ZVAP Tropojë të vërë në dispozicion kopje të dosjeve të aplikimit për personat të cilët janë emëruar në pozicionet e lira të punës për mësues të edukimit fizik, nga ana e saj u përcollën një pjesë e dokumentacionit që lidhen me arsimin e mësueseve të emëruara për 2 pozicione (në shkollën “Ali Iber Neza”, Tropojë dhe “Murat Paci”, Pac). Pra, nuk u vu në dispozicion dokumentacioni i plotë i kërkuar nga Komisioneri, lidhur me plotësimin e kërkesave të tjera të punësimit për mësues të edukimit fizik.
- Nga ana e ZVAP Tropojë nuk u përcoll asnjë informacion lidhur me emërimin e mësuesit e edukimit fizik në shkollën “Mushak Kadria”, Margegaj.
- Nga analiza e bërë akteve ligjore dhe nënligjore sipërcituar, për punësimin e mësuesit në një pozicion të lirë pune në arsimin parauniversitar, në ndryshim nga sa është kërkuar nga ZVAP Tropojë për ankuesen lidhur me gjendjen gjyqësore të saj (vërtetim nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetim nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim), kërkohet vetëm vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore. Pra, në tejkallim të dokumentacionit të kërkuar nga legjislacioni, ZVAP Tropojë i ka kërkuar ankueses dokumentacion që nuk lidhet me punësimin e mësuesit në një pozicion të lirë pune në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ZVAP Tropojë, nuk rezulton që mësuesit e emëruar (në shkollën “Ali Iber Neza”, Tropojë dhe “Murat Paci”, Pac), të kenë dorëzuar dokumentacionin që i është kërkuar A. A..
- ZVAP Tropojë, ka keqinterpretuar nenet 60 dhe 60/1 të Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pikën 4/1 të Kreut 2 dhe pikën 1 të Kreut 10 të Udhëzimit Nr. 17, datë 26.7.2023, të Ministrit për Arsimin dhe Sportin, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2012 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- Lidhur me këtë moment, aktet ligjore apo nënligjore sipërcituar parashikojnë pezullimin, largimin puna apo mospranimin për të emëruar një mësues, kur ai është i dënuar me vendim penal të formës së prerë, kryesisht për vepra penale të natyrës seksuale. Pavarësisht këtij fakti, ZVAP Tropojë e ka vënë ankuesen në të njëjtat pozita me të dënuarit me vendim penal të formës së prerë apo ata të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale edhe pse ajo

nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e sipërpërmendura. Pra, haptazi është keqzbatuar dhe keqinterpretuar kompetenca e ZVAP Tropojë, duke e vënë ankuesen në kushte të pabarabarta me persona të tjerë dhe duke i kërkuar dokumentacion shtesë nga ai i kërkuar kandidatëve të tjerë, si dhe nga ai i kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Kodi i Procedurës Administrative<sup>7</sup> dhe Kodi i Punës, i ndryshuar<sup>8</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/subjektit ndaj të cilit paraqitet ankesa, në këtë rast, ZVAP Tropojë, i cili është subjekti që duhet të provonte se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të paligjshme a të pafavorshme.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesja është cenuar në të drejtën e saj për ushtrimin e profesionit, për trajtimin me dinjitet bazuar në respektimin e drejtës së saj për punësim, si dhe për t'u zhvilluar e rritur profesionalisht. Në kushtet e vendosjes së kriterëve shtesë vetëm për të dhe duke e vënë në pozita të barabarta me persona të tjerë të cilët nuk ndodhen në të njëjtat kushte me të, asaj i është mohuar e drejta e saj ligjore si punëmarrëse, për të pasur një vend pune.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e ZVAP Tropojë.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>9</sup>, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

---

<sup>7</sup>Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

<sup>8</sup>Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: “10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

<sup>9</sup>“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”



Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

## **B.1 Gjendja arsimore**

Ankuesja ka pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, duke pretenduar se është trajtuar në mënyrë të diferencuar në marrëdhëniet e punës, nga ZVAP Tropojë, me arsyetimin se në pozicionet e lira për mësues të edukimit fizik, në ndryshim nga ajo, janë emëruar mësues që nuk plotësojnë kriterin arsimor të kërkuar.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, Komisioneri vlerëson se ky shkak parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. LMD nuk jep ndonjë përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes arsimore. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, se diferencat në trajtim që bazohen në nivelin e arsimit të një personi<sup>10</sup> ose nivelin e arritjeve në arsim të një personi ose e thënë ndryshe në vlerësimet apo notat e përfituara gjatë ndjekjes së arsimit<sup>11</sup>, do të konsiderohen si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore. Komisioneri vlerëson se, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person i nënshtrohet për shkak të nivelit individual të arsimit, arritjeve të tij në arsim, aftësive, certifikatave ose diplomave që një person posedon.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja ka dokumentuar shkakun e gjendjes arsimore nëpërmjet dokumentit përkatës, diploma për përfundimin e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në programin e studimit “Edukim Fizik dhe Sporte”, dhe në këtë logjikë do të pranojë si shkak të justifikuar të LMD-së, pasi rezulton i provuar e dokumentuar.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky shkak i poseduar nga subjekti ankues konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

## **B. 2 Gjendja shoqërore dhe “çdo shkak tjetër”**

Gjatë parashtrimeve të tij, subjekti ankues ka pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore dhe “çdo shkak tjetër”, duke argumentuar dhe provuar se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm ndaj saj, nga ZVAP Tropojë, ka të bëjë me faktin se ajo ndodhej nën hetim e ndaj saj kishte çështje penale që po ndiqej nga ana e Prokurorisë Tropojë.

<sup>10</sup> Shiko: Vendimi nr. 147, datë 26.10.2020, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>11</sup> Shiko: Vendimi nr. 48, datë 19.05.2020, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjendja gjyqësore, e cila në kontekst të shkaqeve të LMD-së, cilësohet si gjendje shoqërore<sup>12</sup> e ankueses vërtetohet nga statusi i çështjeve penale, për të cilat citojmë 3 vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë: Vendimin nr. 47, datë 12.07.2022, Vendimin nr. 94, datë 22.11.2022 dhe Vendimin nr. 05, datë 17.01.2023. Bazuar në gjendjen e saj gjyqësore, ankuesja ka argumentuar se është diskriminuar nga ZVAP Tropojë, pavarësisht se nuk kishte një vendim fajësie të formës së prerë nga organet kompetente, por ishte nën hetim për shkak të detyrës së ajo kishte mbajtur si Përgjegjëse e ZVASHK Tropojë.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh<sup>13</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh<sup>14</sup>.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim

<sup>12</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

...Gjendja shoqërore është baza për mbrojtje e cila lidhet me origjinën e personit, lidhshmërinë e tij me ndonjë profesion të caktuar, me statusin e tanishëm ose të mëparshëm të një të burgosuri, emigranti, të një të sëmuri në institucion psikiatrik, etj. Gjendja shoqërore i referohet dhe ndonjë tipari personal të cilin ka, ose supozohet se ka...Shembull: Një person i cili më parë ka qenë i dënuar, edhe krahas posedimit të kualifikimeve të përshtatshme dhe lejes së punës, nuk punësohet vetëm për shkak të statusit të tij të mëhershëm si ish i dënuarit, paçka se ligji nuk e pengon dhe pa arsyetim për këtë; një trajtim të ndryshëm gjatë qasjes në mallra dhe shërbime, varësisht nga pamja fizike ose veshja, përmes të cilave një person lidhet me një status të caktuar shoqëror.

<sup>13</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>14</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.<sup>15</sup> Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.<sup>16</sup> Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”<sup>17</sup>.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit *i burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar* (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”.

***Në lidhje me pretendimin për diskriminim për çdo shkak tjetër***, subjekti ankues nuk vuri në dispozicion të shqyrtimit të çështjes asnjë informacion apo provë, për të argumentuar ekzistencën e cilësi personale të identifikueshme apo se si ajo ka ndikuar në sjelljen diskriminuese të pretenduar.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja ka dokumentuar shkakun e gjendjes shoqërore nëpërmjet dokumentit përkatës, shkresës Nr. 759/1 prot., datë 19.03.2023, lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, rezulton se ndaj ankuses janë rregjistruar kërkesa penale dhe në këtë logjikë do të pranojë si shkak të justifikuar të LMD-së, pasi rezulton i provuar e dokumentuar.

---

<sup>15</sup> Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Ruisë*, prg. 90.

<sup>16</sup> Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

<sup>17</sup> Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

### **C. 1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, të subjektit ankues nga ana e ZVAP Tropojë, me gjendjen arsimore.**

Mbështetur në analizimin e fakteve e provave të depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm, nga ana e ZVAP Tropojë, lidhur me mohimin e të drejtës së saj ligjore për të pasur një vend pune.

Nga ana e ZVAP Tropojë, në keqzbatim dhe keqinterpretim të kompetencave të saj, e ka vënë ankuesen në kushte të pabarabarta me persona të tjerë dhe duke i kërkuar dokumentacion shtesë nga ai i kërkuar kandidatëve të tjerë, si dhe nga ai i kërkuar nga legjislacioni në fuqi. Gjithashtu, e ka vënë ankuesen në kushte të barabarta me persona të tjerë të cilët nuk ndodhen në të njëjtat kushte me të.

“Gjendja arsimore” është shkak i pretenduar diskriminimi nga ana e subjektit ankues, për të cilin ka pretenduar se ka shërbyer si shkak për trajtimin e saj të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e ZVAP Tropojë, dhe këtë pretendim e lidh me faktin se ajo është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me mësuesit e tjerë të edukimit fizik për shkak të gjendjes arsimore. Pra, duke argumentuar se, në ndryshim nga ajo, mësuesit e tjerë të edukimit fizik të emëruar nuk plotësojnë kriteret e kërkuara të arsimit.

Gjatë procedurës hetimore, Komisioneri ka konstatuar se në ZVAP Tropojë, janë emëruar 2 (dy) mësuese të edukimit fizik, një nga portali “Mësues për Shqipërinë” dhe një nga jashtë portalit, të cilat kanë përfunduar ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në profilin “Mësues të Edukimit Fizik”. Gjithashtu edhe ankuesja, ka të njëjtin arsimim me 2 (dy) mësueset e tjera të edukimit fizik, cituar më sipër.

Pra, bazuar në këto të dhëna, 2 (dy) mësueset e tjera të emëruara në ZVAP Tropojë, për lëndën e edukimit fizik janë në të njëjtat kushte me ankuesen, pra, gjendja arsimore e saj nuk ka shërbyer si shkak për trajtim të diferencuar, duke i mohuar asaj të drejtën për punësim.

Gjatë procedurës hetimore të shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të provohej që pikërisht shkakun e gjendjes arsimore të ketë shërbyer si shkak apo motiv që ajo të ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Për rrjedhojë, KMD vlerëson se, pretendimet e ankueses për diskriminim bazuar në këtë shkak, nuk krijojnë prezumimin mbi bazën e provave të drejtpërdrejta apo të tërthorta të sjella prej saj, që sjellja e ZVAP Tropojë, kundrejt saj të jetë motivuar nga shkakun e gjendjes arsimore.

Në bazë të provave të administruara Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton të ketë një lidhje shkakësore midis trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesja lidhur me mohimin e të drejtës për punësim dhe shkakut të gjendjes arsimore.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk arriti të provojë se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm i ankueses, të kishte ardhur për shkak të gjendjes arsimore.

### **C. 2 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, të subjektit ankues nga ana e ZVAP Tropojë, me shkakun e “gjendjes shoqërore”.**

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e ZVAP Tropojë, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të “gjendjes shoqërore”, sipas shpjegimit të bërë në pjesën B. 2, të vendimit.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.<sup>18</sup>

Gjykata Kushtetuese<sup>19</sup>, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

*Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.*

*E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi.*

<sup>18</sup> Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

*Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.*

*Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.*

Në rastin në fjalë, Komisioneri konsideron se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga dispozitat ligjore në fuqi.

Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene Kodin e Punës, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor<sup>20</sup>.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës*

---

<sup>20</sup>Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011.

*private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>21</sup>”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.*

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>22</sup> *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,* përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si - *çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.*

Konventa për Dhunën dhe Ngacmimin, e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO, 1986), (ratifikuar me ligjin nr. 13/2022), në nenin 12, të saj përcakton se: *“Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen me anë të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si dhe nëpërmjet marrëveshjeve kolektive ose masave të tjera në përputhje me praktikën kombëtare, duke përfshirë zgjerimin ose përshtatjen e masave ekzistuese të sigurisë dhe shëndetit në punë, për të trajtuar dhunën dhe ngacmimin dhe zhvilluar masa specifike, në rastet kur është e nevojshme”.* Konventa përcakton se:

<sup>21</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>22</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

*“Kjo Konventë mbron punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi.”.*

Në frymë dhe në nene ajo përcakton të drejtën e punonjësit për *punën e denjë*, respektim të dinjitetit e personalitetit të tij profesional.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, Shqipëria është shtet anëtar me të drejta dhe detyrime të plota i Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”* (Konventa e CEDAW), e cila ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në çështje të tilla që lidhen me të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme, të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, si dhe një sërë të drejtash të tjera që rrjedhin nga punësimi (neni 11)<sup>23</sup>.

*Karta Sociale Europiane*<sup>24</sup> në nenin 1, pika 2, parashikon: *“ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...”*

Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>25</sup>.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Sociale Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme<sup>26</sup>.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të

<sup>23</sup> Citojmë këtu, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 16, datë 12.03.2024.

<sup>24</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>25</sup> Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

<sup>26</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.



ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*. Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në bazë të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>27</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kështu, në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: “*Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë*”.

<sup>27</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 16, datë 12.03.2024, të saj, ka mbajtur qëndrimin se: *“...aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi”<sup>28</sup>.*

Në këtë kuadër, në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë

diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime *“...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara”<sup>29</sup>.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie*

<sup>28</sup> Paragrafi 38, i Vendimit Nr. 16, datë 12.03.2024 të GJK.

<sup>29</sup> GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rosisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse ZVAP Tropojë, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>30</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standardin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e ZVAP Tropojë, përse i takon mohimit të të drejtës për punësim.

Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar fakti që ankuesja e mbart shkakun e sipërpërmendur, të gjendjes shoqërore, si person nën hetim lidhur me akuzat për disa vepra penale, si: “Shpërdorim detyrë”, “Falsifikim të dokumenteve”, “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik”, etj, për të cilat, ndër të tjera, citojmë vendimet respektive të organeve të drejtësisë, si:

- Vendimi nr. 47, datë 12.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- Vendimi nr. 05, datë 17.01.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë (vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 22.01.2023), ku ka vendosur:
  1. *Pranimin e kërkesës së personit nën hetim A. A.*
  2. *Konstatimin e shuarjes së masës ndaluese “Pezullimi i ushtrimit të një detyrë”, të caktuar ndaj personit nën hetim A. A. me vendimin Nr. 47, datë 12.07.2022 dhe vendimin Nr. 47/1, datë 18.07.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.*
  3. *Urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë për ekzekutimin e këtij vendimi.*

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesja janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se mohimi i të drejtës për punësim, ka ardhur pikërisht për shkakun e pretenduar, atë të gjendjes shoqërore, faktit që ajo ishte

<sup>30</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

një person nën hetim, pavarësisht faktit se ndaj saj nuk kishte një vendim fajësie (të formës së prerë), mbi të cilin ajo të shpallej e fajshme.

Nga ana e ZVAP Tropojë, nuk u sollën prova dhe argumente bindës që të mund të provonin apo përlijnin faktin se nuk është punësuar si mësuese e edukimit fizik, për shkak të mosplotësimit të kriterëve ligjore apo mungesës së dokumentacionit të depozituar. Sipas provave të administruara, në ndryshim nga ankuesja, ZVAP Tropojë nuk arriti të dokumentojë faktin që A. A. nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për pozicionet e lira të punës si mësues të edukimit fizik në institucionet arsimore nën juridiksionin e saj.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, veprimet a mosveprimet ZVAP Tropojë, lidhur me mohimin e të drejtës për tu punësuar si mësuese e edukimit fizik, janë haptazi në kundërshtim me të drejtat e saj ligjore, për ushtrimin e profesionit, normuar nga legjislacioni për marrëdhëniet e punësimit në fushën e arsimit.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e ZVAP Tropojë, kundrejt subjektit ankues dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, ZVAP Tropojë, duhet të përmbushte njërin nga dy kushtet e përmendura më sipër.

Komisioneri konstaton se, ZVAP Tropojë, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për emërimin e mësuesve në arsimin parashkollor, nuk ka provuar se:

- Ankuesja nuk është punësuar si mësuese e edukimit fizik në një nga pozicionet e lira në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë për shkak se nuk ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar apo për shkak të mosplotësimit të kriterëve të pozicionit të punës;
- Nuk u sollën prova, fakte a dokumente që dokumentacioni i kërkuar ankueses (vërtetim nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetim nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim), i është kërkuar edhe kandidatëve të tjerë të cilët janë emëruar apo kanë aplikuar për punësim në pozicionet e lira si mësues të edukimit fizik, në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë. Në këtë rast, vetëm ankuesja është ngarkuar me detyrimin e dorëzimit të vërtetimit nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetimit nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim.

Për më tepër, Komisioneri vëren se, nga ana e ZVAP Tropojë, duke interpretuar në mënyrë të gabuar legjislacionin në fuqi, ankuesja është vënë në të njëjtat pozita me të dënuarit me vendim

penal të formës së prerë apo ata të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale edhe pse ajo nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e sipërpërmendura. Pra, haptazi është keqzbatuar dhe keqinterpretuar kompetenca e ZVAP Tropojë, duke e vënë ankuesen në kushte të pabarabarta me persona të tjerë dhe duke i kërkuar dokumentacion shtesë nga ai i kërkuar kandidatëve të tjerë, si dhe nga ai i kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri vëren se, ZVAP Tropojë nuk duhet të kishte vënë në të njëjtat pozita, përjashtuese nga legjislacioni në fuqi, ankuesen dhe personave të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale.

Pra, haptazi është keqinterpretuar dhe keqzbatuar legjislacioni në fuqi, duke mos e pranuar kërkesën për punësimin e saj, me arsyetimin se nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar (vërtetim nga prokuroria që nuk ka në ngarkim asnjë proces penal, dhe vërtetim nga gjykata se nuk është në një proces gjyqësor në vazhdim) dhe duke e vënë në pozita të barabarta me persona të dënuar për vepra penale të natyrës seksuale.

Komisioneri vëren gjithashtu se, ZVAP Tropojë, ka patur dijeni lidhur me faktin që ankuesja ka qenë nën hetim nga ana e Prokurorisë Tropojë dhe në gjykim nga ana e Gjykatës Kukës, për shkak se këtë dokumentacion e ka dorëzuar në momentin që ka aplikuar për zhvillimin e praktikës profesionale.

Në këtë kontekst, ZVAP Tropojë, me veprime konkludente ka dëshmuar se pikërisht se për këtë shkak i ka mohuar të drejtën për punësimin e saj si mësuese e edukimit fizik, duke parajgykuar se ajo ishte person nën hetim nga organet përkatëse, dhe ky fakt provohet nga përgjigjet e përcjella ankueses dhe KMD-së nga ana e ZVAP Tropojë, duke cenuar kështu parimin e prezumimit të pafajësisë.

Sipas Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë (*neni 30 i Kushtetutës*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë.<sup>31</sup> (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

Arsyet e dhëna nga ZVAP Tropojë, lidhur me mohimin e punësimit të saj si mësuese e edukimit fizik, nuk rezultojnë të provuara dhe nuk qëndrojnë.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri, gjykon se, veprimet dhe mosveprimet e ZVAP Tropojë (mohimi i së drejtës për punësim), duke mos gjetur edhe mbështetje e argument ligjor, haptazi ka

<sup>31</sup> Vendim nr. 47 datë 20.04.2022, i GJK.

qenë e motivuar pikërisht nga gjendja shoqërore e saj, fakti që ka qenë person nën hetim nga organet përgjegjëse, dhe se asaj i është cenuar një e drejtë themelore kushtetuese, siç është e drejta e ushtrimit të detyrës dhe profesionit.

Puna është një veprimtari jetike e individëve të aftë për punë. Ajo është burimi i të ardhurave që ata sigurojnë mjetet e jetesës. Gjithashtu, marrëdhënia e punës (*punësimi*) është, përveç të tjerash, një marrëdhënie sociale dhe shoqërore.

Punëdhënësi ka detyrimin të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësve, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e shëndetit mendor, emocional dhe fizik të tyre, si dhe trajtimin me dinjitet të tij.

E drejta për punë buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e sanksionuar dhe e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo organ në marrëdhëniet e punës, që të ndër marrë veprime në përputhje me të drejtën e punonjësve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm i ankueses, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

**Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se ZVAP Tropojë, e ka diskriminuar A. A., në të drejtën për punësim, pasi mohimi i të drejtës për punësimin e saj, duke keqinterpretuar dhe keqzbatuar legjislacionin në fuqi, është në kundërshtim flagrant të respektimit të së drejtës së punonjësit për të ushtruar profesionin dhe i motivuar për shkak të gjendjes së shoqërore të saj, paragjykimin si person nën hetim nga organet përkatëse.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit, të subjektit ankues, A. A., në të drejtën për punësim, nga ana e ZVAP Tropojë, për shkak të gjendjes shoqërore të saj.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjektit ankues, A. A., në të drejtën për punësim, nga ana e ZVAP Tropojë, për shkak të gjendjes arsimore.
3. Në referim të pikës 1, ZVAP Tropojë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke pranuar aplikimin e A. A., për punësimin e saj si mësuese e edukimit fizik me

kontratë me afat të caktuar, nga jashtë portalit "Mësues për Shqipërinë", në një nga pozicionet e lira të punës në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tropojë.

4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ZVAP Tropojë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja shoqërore)  
(Fusha: Punësim)